REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 994 Lushnje më 26/01.2026

RAPORT

PËR PUNËN KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT 2025

PER DIJENI: KRYETARIT TE KESHILLIT

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efiçencë dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Lushnje mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vete këshilli si më poshtë:

1. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"
3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
4. Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetë-Qeverisjen Vendore"
5. Ligji nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative"
6. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"
7. Ligji nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"

8. Ligji nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit"
9. Ligji nr. 146, datë 301.10.2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"
10. Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
11. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menazhximin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
12. Ligji nr. 9970, datë 24.70.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"
13. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
14. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"
15. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave",i ndryshuar
16. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
17. Ligji nr. 138, datë 17.12. 2015 "Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike". 19. Ligji nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar
18. Rregullore e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lushnje, me Vendim nr.37, datë 24.04.2020
19. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshillitarit Bashkiak
20. Rregullore për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median.
21. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare.

Gjate vitit 2025 jane realizuar ne total 12 mbledhje te Keshillit Bashkiak Lushnje.

Ne total jane miratuar **125** vendime nga te cilet 18 jane akte normative te cilat jane konfirmuar ne perputhje me ligjin nga Prefekti i Qarkut Fier. Gjithashtu jane realizuar 11 mbledhje Kryesie , 9 mbledhje te Komisionit Juridik dhe Situatave Emergjente ,1 mbledhje te Komisionit te Arsimit ,9 mbledhje te Komisionit te Ekonomise Problemeve Sociale dhe Strehimit , 2 mbledhje te Komisionit Mandateve dhe Rishikimit te Rregullores.

Këshilli i Bashkisë Lushnje, gjatë 12-mujorit të vitit 2025 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. Shqyrtimi dhe miratimi më i madh i vendimeve i kushtohet familjeve meprobleme të thella sociale.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje si më poshtë :

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje *nga të ardhurat e Bashkisë*	Ndihmë ekonomike për familje *nga fondi i kushtëzuar 6 %*
1.	Janar	97	19
2.	Shkurt	97	28
3.	Mars	96	28
4.	Prill	99	34
5.	Maj	104	33
6.	Qershor	103	32
7.	Korrik	98	33

33

8.	Gusht	96	34
9.	Shtator	101	31
10.	Tetor	101	33
11.	Nëntor	105	35
12.	Dhjetor	109	35

Këshilli ka marrë, me date 30.05.2025 vendimin me numer 43 date 30.05.32025"Per miratimin e prishjes se shkolles Hyzgjokaj.venmdimin nr .35 date 01.04.2025Per miratimin e dokumentit vleresimit te kapitalit natyror.vendimin nr 36 date 01.04.2025:Draft strategjia vendore per zvogelimin e riskut ,vendimi nr 55 date 30.06.2025Per rishikimin e dokumentit "Plani vendore i emergjencave civile,bashkia Lushnje",vendimi nr 74 date 23.07.2025"Per miratimin e planit vendore per barazi gjinore".vendimi nr 81 date 29.08.2025 "Per miratimin e planit te arsimit parauniversitar",vendimi nr 82'Per miratimin e planit social vendor 2025-2028,vendimi nr 83 date 29.08.2025"Per miratimin e planit te integritetit Lushnje',vendimi nr 85 date 29.08.2025 "Per miratimin e planit te mbareshtimit te pyjeve ".

Krahas këtyre vendimeve keshilli ka miratuar vendime për :

- Per dhenien e ndihmes ekonomike
- Per perfundimin e procesit te privatizimit te banesave .
- Per subvencionimin e qirase .
- Per dhenie me qera .
- Mbi miratimin e shpronesimeve per interes publik te pasurive prone private qe preken nga realizimi i investimit
- Mbi shperblimin e sportistes Gea Dokollari Laurenc Hasko si dhe shperblim per ekipin e volejbollit Lushnja dhe te trajneres se saj,Erilda Allkanjari
- Mbi miratimin e bursave per shkollat profesionale.
- Per shperblimin e nxenesve ekselente.
- Per perdorimin e fondit te emergjencave civile si rezultat i renies se zjarrit ne banesa .
- Per miratimin e taksave dhe tarifave si dhe buxhetin e bashkise per vitin 2026 .
- Per dhenie titulli qytetar nderi.

-Mbi miratimin e investimeve te ndryshme.

-Per regjistrime trojesh te dhena per ndertim nga Nj.Q.V.

Sic e thame me larte për periudhën janar – dhjetor 2025, janë marrë ne total 125 vendime në Këshillin Bashkiak Lushnje nga te cilat 18 jane akte normative te cilat jane objekt kontrolli nga Prefektura Fier.Vetem V.K.B nr 113 date 21.11.2025 'Per miratimin e listes se perdoruesve faktike te kalimit ne pronesi pa shperblim te tokes bujqeosre ,Prefektura Fier eshte shprehur me shkresen nr 1293/1 date 27.11.2025 se nuk eshte kompetence e saj pasi ky akt nuk eshte normativ.Te gjitha vendimet e marra jane te publikuara ne kendin e shpalljes ,ne **web-in** e bashkise si dhe te **vendime.al** gjithashtu ne web jane te publikuara dhe projekt vendimet, dokumentacioni per konsultimet qe jane te detyruar per keshillin si dhe cdo aktivitet qe zhvillon keshilli bashkiak .Gjithashtu keto vendime jane te pasqyruara ne regjistrin per numertimin e vendimeve dhe ne regjistrin per shpalljen e vendimeve .
Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Lushnje kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2025 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra me karakter normativ.
Nga Prefektura Fier është kryer kontroll sipas legjislacionit dhe në raportet tre mujore është cilësuar se Këshilli Bashkiak Lushnje ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore dhe nuk ka lene rekomandime per periudhen objekt kontrolli.
Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Bashkise Lushnje.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë aktiv, duke mbajtur mbledhje të radhës, sipas tabelës së mëposhtëme :

Muaji	**Nr i mbledhjeve**	**Mbledhje të radhës**	**Mbledhje jashtë radhe**	**Mbledhje të jashtëzakondshme**
Janar	1	23.01.2025		-
Shkurt	1	25.02.2025		
Mars	1	01.04.2025		-
Prill	1	23.04.2025		-
Maj	1	30.05.2025	-	-
Qershor	1	30.06.2025		-
Total 6 mujor parë	6	6	0	0
Korrik	1	23.07.2025		-

Gusht	1	29.08.2025	-	
Shtator	1	29.09.2025	-	-
Tetor	1	30.10.2025	-	-
Nëntor	1	21.11.2025		-
Dhjetor	1	23.12.2025		-
Total 6 mujor dytë	**6**	**6**	**0**	**0**

Periudha	Nr i mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë radhe	Mbledhje të jashtëzakondshme
6 mujori parë	6	6	0	0
6 mujori dytë	6	6	0	0
Total 12 mujori	**12**	**12**	**0**	**0**

Kalendari i zhvillimit të mbledhjeve paraqitet si më poshtë :

Nr.	DATA E MBLEDHJES	ORA	VENDI I ZHVILLIMIT
1	23.01.2025	11:00	Salla e keshilllit
2	25.02.2025	10:00	Salla e keshilllit
3	01.04.2025	10:30	Salla e keshilllit
4	23.04.2025	10:00	Salla e keshilllit
5	30.05.2025	10:00	Salla e keshilllit
6	30.06.2025	10:00	Salla e keshilllit
7	23.07.2025	10:00	Salla e keshilllit
8	29.08.2025	10:00	Salla e keshilllit
9	29.09.2025	12:00	Salla e keshilllit
10	30.10.2025	13:30	Salla e keshilllit
11	21.11.2025	13:00	Salla e keshilllit
12	23.12.2025	13'00	Salla e keshilllit

Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projektvendimete sjella nga administrata e bashkisë Lushnje. Për periudhën 12-mujore janë bërë 21 mbledhje të komisioneve të përhershëm, 9 mbledhje te Komisionit Juridik dhe Situatave Emergjente ,1 mbledhje te Komisionit te Arsimit ,9 mbledhje te Komisionit te Ekonomise Problemeve Sociale dhe Strehimit , 2 mbledhje te Komisionit te Manadteve dhe Rishikimit te Rregullorers.

Nr.	Muaji	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm
1.		
2.	Shkurt	2
3.	Mars	2
4.		
5.	Maj	2
6.	Qershor	1
	Total 6 mujori I-rë	**7**
7.	Korrik	2
8.	Gusht	2
9	Shtator	2
10	Tetor	3
11	Nëntor	3
12	Dhjetor	2
	Total 6 mujori II-të	**14**
	TOTALI 12 MUJOR	**21**

Në çdo rast Komisionet e Përhershme në zbatim të "Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lushnje" kanë mbajtur proces verbal si dhe kane pasqyruar vendimmarrjen e tyre për pikat e rendit të ditës, që u janë caktuar për t'i shqyrtuar.

Nr.	Periudha	Vendimet e Komisioneve të Përhershëm
	Totali 12 mujor	77

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:

1. Për probleme financiare
2. Për probleme sociale
3. Për infrastrukturën dhe strehimin
4. Për problemet urbane dhe asetet
5. Për emergjencat civile
6. Për probleme të arsimit kulturës

7.Miratim marreveshje bashkepunimi.

Gjthashtu pothuajse te gjithe vendimet e keshillit jane zbatuar nga administrata .Ato vendime qe nuk jane zbatuar ende , ka arsye objektive.

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :
Rreth Këshillit Bashkiak
Struktura e Këshillit Bashkiak
Anëtarët e Këshillit Bashkiak
Përbërja e Komisioneve
Rregulloret
Kalendari Mbledhjeve të Këshillit
Njoftime (KB)
Projekt-vendimet në proçes shqyrtimi nga KB
Vendime të Këshillit Bashkiak
Konsultimet Publike
Regjistri i projekt akteve për konsultim publik të këshillit bashkiak
Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti
Dëgjesa Publike

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike (*si në faqen zyrtare të Bashkisë, në media vendore, me email drejtuar OJF, Drejtorëve të bashkisë, Kryetarëve të Njesive Administrative, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Lushnje*) në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lushnje .

Në protokollin e Sekretariatit kanë hyrë shkresa zyrtare (*sqarojmë se disa shkresa nuk kanë patur nevojë për përgjigje pasi ka qenë për dijeni drejtuar kryetarit apo këshilltarëve, të cilëve*

sekretariati ia ka vënë në dijeni përmes postës elektronike apo aplikacioneve te ndryshme.

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përçimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka hapur faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilin bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merr vërejtje, ankesa, kërkesa e sygjerime nga qytetarë të ndryshëm. Disa mbledhje plenare të këshillit janë transmetuar direkt dhe nëpërmjet këtij rrjeti,ku komuniteti ka ndjekur direkt mbledhjen dhe ka dhënë mendimet për çështjet që janë shqyrtuar,megjithate cilesia e transmetimit te mbledhjes nuk eshte akoma ne nivelin e duhur .Shpresojme qe me rikonstruksionin e bashkise salla e keshillit te pajiset me te gjithe teknologjine e kohes per te zhvilluar mbledhje me standart te larte ,ku te perfshihen votimi elektronik ,sistemi audio video ,etj ne perputhje kjo dhe me rregulloren e keshillit bashkiak .

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje "Te ndryshme" (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Këshilli Bashkiak në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2026 :Për
zërin 602 –ka 500.000 lekë.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 "Për konsultimin publik" gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, këshilli në bashkëpunim me bashkinë ka mundur të zhvilloj konsultime publike, lidhur me miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, projekt buxhetin e vitit 2026 .
Këshilli nëpërmjet faqes së tij online ka hapur një rubrikë të konsultimeve me publikun si një nga mënyrat e pjesëmarrjes së komunitetit për të përcjell shqetësimet e sygjerimet e tij. Dhe në këtë faqe publikohen të gjitha projektvendimet, që sipas ligjit para se të shqyrtohen kërkojnë seanca dëgjimore.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Punë të mbarë për vitin 2026 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!